



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, të Ligjit nr. 03/ L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 2.11.2023, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR “GROWZILLAS L.L.C”

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për “GROWZILLAS L.L.C”.

II.

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 5.000,00 € (pesë mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve.

III.

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, për “GROWZILLAS L.L.C”, për organizmin e konferencës “Growth Tank”, konferencë kjo që ka për qëllim sjelljen e ekspertëve më të mëdhenj të fushës së marketingut digjital në Prishtinë.

IV.

Pjesë e këtij vendimi është kërkesa me dokumentet përcjellëse, e Benjamin Kolenovic, përfaqësues i “GROWZILLAS L.L.C” .

V.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

VI.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/04-215767/23, më 03.11.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Pëllumb Bajcinovci

